

URDHËR
Nr. 852, datë 1.12.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për procedurën me objekt: *“Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish-Kinostudios ‘Shqipëria e Re’, Tiranë, faza II*” drejtorit të përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Edlira Cimbi.
2. Delegimi i kompetencave sipas pikës 1 të këtij urdhri është i vlefshëm për datat 1.12.2022 dhe 2.12.2022.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Edlira Cimbi.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti